

Shoqata “NdiHmoni Jetën”, është një organizatë kombëtare me një eksperiencë prej 20 vjetësh në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe ofrimit të Shërbimeve të aftësisimit për jetën, të fëmijëve dhe të rinjëve me aftësi të kufizuar, në Qendër ditore, komunitet dhe gjithëpërfshirje në sistemin arsimor.

Shoqata, do të implementoj projektin **“Rruga drejt jetesës së pavarur/Pathing the Way toward the Independent Living** në kuadër të projektit **‘Askush të Mos Mbetet Pas/Leave No One Behind (LNB)’**, një Projekt i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga katër agjencitë e OKB-së UNDP, UNFPA, UNICEF dhe UN Women, në partneritet me Qeverinë Shqiptare që synon të fuqizojë personat vulnerabel në Shqipëri që të kenë akses dhe mundësi të barabarta në shërbime publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike që ndikojnë në jetën e tyre, të mbajnë përgjegjësi dhe tu njihet kjo drejtë.

Qëllimi I këtij projekti është të “Mundësoj personat me aftësi të kufizuara intelektuale përmes shërbimeve efektive mbështetëse, të ushtrojnë të drejtën e tyre për të jetuar të pavarur në komunitet.

Objektivat e projektit janë:

1. Modelimi I një Shërbimi mbështetës për personat me aftësi të kufizuar intelektuale për të ushtruar të drejtën e tyre për të jetuar të pavarur në komunitet, si pjesë e Shërbimeve Komunitare.
2. Pilotimi i këtij Modeli të Shërbimit, me qëllim ndarjen e mëtejshme të tij me Institucionet Shtetërore përkatëse për miratimin dhe replikimin e tij në vend.

Projekti kërkon punësojë Punonjës Social (me kohë të plot) I cili do të ofrojë asistencën e tij për të rinjtë me aftësi të kufizuar të targetuara nga ky projekt dhe familjet e tyre.

Përgjegjësitë specifike:

1. Punonjësi social ka rolin e personit të kontaktit ndërmjet Shërbimit të Jetesës së pavarur dhe familjes. Detyrat e tij janë:

- Të vlerësojë situatën socio-ekonomike të familjes së personit, të gjenerojë informacion të detajuar mbi gjendjen socio-ekonomike të familjes, kushtet e tyre të jetesës dhe nivelin e mbështetjes që familja i jep personit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ai analizon marrëdhëniet që ekzistojnë brenda familjes,
- Informon familjen për dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e dosjes personale
- Mban kontakt të rregullt me familjen në drejtim të këshillimit dhe mbështetjes në këtë fazë të re të jetës së tyre
- Mban kontakt të rregullt me familjen për progresin e personit me aftësi të kufizuara dhe problemet specifike që mund të shfaqë gjatë programit të jetesës së pavarur

- Shoqëron personin me aftësi të kufizuar në institucione të ndryshme, në rast se kjo kërkohet nga ekipi multidisiplinar si pjesë e EIP.

2. Punonjësi social është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe jep mendimin e tij gjatë:

- Vlerësimin të nevojave psiko-sociale të personit me aftësi të kufizuara dhe përshkrimi i tyre në formën e "Informacionit të Përgjithshëm"
- Harton PEI: vlerëson problemet psiko-sociale të personit me AK
- Rivlerësimi I kapaciteteve të personit pas gjashtë muajve, sipas PEI.

3. Punonjësi social realizon PEI të fëmijës, në grup ose individualisht, kryesisht në këto drejtime:

- marrëdhëniet dhe socializimi
- ekuilibri psiko-emocional
- Rritja e kapaciteteve në fushën e autonomisëve
- Rritje e kapacitetit në drejtim të shprehjes ndaj vetes dhe ndaj ambientit ku jeton
- Rritja e kapacitetit të funksionimit në komunitet
- Modifikim të sjelljeve të papranueshme
- Diskutimi i temave sociale duke stimuluar pjesëmarrjen aktive, të personave me aftësi të kufizuar
- Organizon lojëra, ekskursione, veprimtari kulturore, sociale, aktivitete sportive, aktivitete ndërgjegjësimi në qendër dhe në komunitet.

4. Punonjësi social është përgjegjës për marrëdhënien e personave të përfshirë në programin e jetës së pavarur në komunitet duke:

- Krijuar një rrjet mbështetës për personat me aftësi të kufizuara në komunitet, ku ata funksionojnë (institucionet e qeverisjes vendore, institucionet shëndetësore, ofruesit e tjerë të shërbimeve etj)
- Organizimi dhe ndjekja e aktiviteteve ndërgjegjësuëse në bashkëpunim me shkollat/institucione në komunitet.
- Organizimi ose ndjekja e ngjarjeve sportive dhe kulturore të mbajtura në komunitet për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

5. Ndjekja dhe Raportimi tek Menaxheri I Programit për realizimin e aktiviteteve sipas afatit kohor.

6. Kohëzgjatja e Kontratës:

- 8 Muaj

7.Orari i punws:

Orari I punes do te jete 8 ore ne dite/ 5 dite ne jave sipas nje grafiku te mirepercaktuar:

Orari:

08.00-16.00

14.00-22-00

20.00-06.00

Kualifikimet

- ❖ Diplomë Universiteti në Punë Sociale (diplomë Bachelor dhe Pas -Universitare);
- ❖ Së paku 3 vjet përvojë pune ne fushwn shwr bimeve tw personave me aftwsi tw kufizuar ose me grupet vulnerabel;
- ❖ Njohuri dhe kuptim të çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe dokumenteve të përcaktuara nga qeveria shqiptare;
- ❖ Aftësi të forta analitike, komunikim me gojë dhe me shkrim dhe aftësi për pwr tw punuar nw ekip;
- ❖ Niveli i mirë i gjuhës Angleze, në shkrim edhe në të folur do të jetë pwrparsi;
- ❖ Njohuri dhe shkathtësi të avancuara të MS Office.

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e parashkruara në këto Terma Reference, mund të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm brënda dates 08/06/2019, ora 16.30 me orën lokale :

- Letër motivimi që shpjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion
- CV e detajuar

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistës do të njoftohen.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni në këtë adresë e-maili: info@helphelife.org.al